

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 109/2017

PËR BUXHETIN E VITIT 2018

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 158 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

BUXHETI

Neni 1

Buxheti për vitin 2018 është:

Të ardhurat	464 702	milionë lekë;
Shpenzimet	497 068	milionë lekë;
Deficiti	32 366	milionë lekë.

Ai përbëhet nga buxheti i shtetit, buxheti vendor dhe fondet speciale: sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe kompensimi i pronarëve.

Neni 2

Buxheti i shtetit për vitin 2018 është:

Të ardhurat	357 853	milionë lekë;
Shpenzimet	390 219	milionë lekë;
Deficiti	32 366	milionë lekë.

Neni 3

Buxheti vendor për vitin 2018 është:

Të ardhurat	46 188	milionë lekë;
Nga të cilat:		
- transfertat e pakushtëzuar nga buxheti qendror	16 580	milionë lekë;
- transfertat specifike	7 421	milionë lekë;

- Të ardhura të tjera	22 187 milionë lekë;
Shpenzimet	46 188 milionë lekë.

Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2018 është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej,	120 251 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	73 480 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	45 076 milionë lekë;
- transfertat nga buxheti për indeksimin e pensioneve	1 695 milionë lekë;
Shpenzimet	120 251 milionë lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe të kategorive të veçanta të personave të vetëpunësuar, duke mbuluar nga buxheti i shtetit diferencën midis këtyre kontributeve me masën e kontributit të përcaktuar për personat e vetëpunësuar në qytet. Për vitin 2018, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

Të ardhurat, gjithsej	5 834 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet	1 176 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	4 533 milionë lekë;
- fondi për indeksimin e pensioneve	125 milionë lekë;
Shpenzimet	5 834 milionë lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është 1 820 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin nr. 61, të ligjit 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2 476 milionë lekë dhe janë të ndara sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta.

Neni 5

Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2018 është:

Të ardhurat, gjithsej,	40 400 milionë lekë;
Nga të cilat:	
- kontributet dhe të tjera	11 906 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	28 494 milionë lekë;
Shpenzimet	40 400 milionë lekë.

Fondi për shërbimin spitalor detajohet dhe përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Buxheti i fondit për kompensimin në vlerë të pronarëve për vitin 2018 është:

Të ardhurat, gjithsej,	4 000 milionë lekë;
Nga të cilat:	

- të ardhura të tjera	1 500 milionë lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	2 500 milionë lekë;
Shpenzimet	4 000 milionë lekë.

Neni 7

Përdorimi dhe investimi i fondit rezervë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II

BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

Grantet	14 500 milionë lekë;
Të ardhurat tatimore	317 597 milionë lekë;
Të ardhurat jotatimore	25 757 milionë lekë.

Neni 9

Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nëpërmjet huamarrjes totale neto nga burime të brendshme dhe të huaja është 32 366 milionë lekë. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Të ardhurat nga privatizimi, që mund të krijohen gjatë vitit 2018, përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale, e cila, automatikisht, rrit me të njëjtën masë kufirin e deficitit të buxhetit të shtetit, të përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji.

KREU III

SHPENZIMET E BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 10

Shpenzimet e buxhetit të shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzime të buxhetit qendror	382 519 milionë lekë;
- Fondi për rritjen e pagave	1 000 milionë lekë;
- Fondi rezervë	2 700 milionë lekë;
- Kontingjencë për risqet e borxhit	4 000 milionë lekë;

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Kufiri i shpenzimeve korrente dhe kapitale për institucionet e sistemit të drejtësisë paraqitet në nënndarjen përkatëse, pjesë e tabelës nr.1.

Në tabelat 1/1 dhe 1/2 janë kufijtë e shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, për shpenzime korrente dhe kapitale, përkatësisht për vitet 2019 dhe 2020. Transferta e pakushtëzuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore miratohet vetëm për vitin 2018.

Të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme fiskale dhe tri vitet e ardhshme janë sipas tabelës 4.

Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet publike, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Neni 11

Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë është 81 753 veta. Numri maksimal i punonjësve për çdo ministri dhe institucion qendror, i dhënë në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, detajohet nga ministrinë dhe institucionet qendrore, në përputhje me strukturat e miratuara për çdo institucion varësie. Këshilli i Ministrave mund të rishpërndajë numrin e punonjësve ndërmjet institucioneve të përmendura në tabelën 2, në rastin e ristrukturimit të institucioneve ekzistuese apo krijimit të institucioneve të reja.

Numri rezervë, i parashikuar në tabelën 2, përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave për krijimin e institucioneve të reja. Këshilli i Ministrave përcakton numrin maksimal të punonjësve me kontratë të përkohshme për çdo ministri dhe institucion qendror. Fondi i veçantë i institucioneve buxhetore prej 500 milionë lekësh shpërndahet dhe përdoret me miratimin e Ministrisë të Financave dhe sipas procedurave që përcaktohen me udhëzim të tij.

Për vitin 2018 nuk miratohet asnjë ndryshim në strukturat organike të njësisve të qeverisjes qendrore me efekte financiare shtesë në koston e personelit, të përlogaritur sipas strukturës së miratuar, me përjashtim të institucioneve të reja dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Ky përcaktim përfshin edhe ato struktura, në të cilat paga për funksion jepet ose është sipas gradës përkatëse, ku çdo rritje në gradë do të bëhet efektive vetëm nëse nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në koston e përlogaritur sipas gradave të miratuara.

Numri i punonjësve të institucioneve ekzistuese të sistemit të drejtësisë dhe numri rezervë për këtë sistem paraqitet në nënndarjen përkatëse në tabelën nr. 2. Detajimi i numrit të punonjësve të institucioneve ekzistuese të sistemit, deri në momentin e riorganizimit, detajohet nga vetë institucionet. Rishpërndarja e numrit të punonjësve të institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe e numrit rezervë të tyre bëhet nga Këshilli i Ministrave, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.

Neni 12

Paga e Presidentit të Republikës është 257 000 lekë në muaj dhe rritet gjatë vitit, sipas përcaktimeve që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Fondi rezervë i buxhetit prej 2 700 milionë lekësh përdoret nga Këshilli i Ministrave:
- deri në 1 700 milionë lekë, për raste të paparashikuara të institucioneve buxhetore,
- deri në 1 000 milionë lekë, për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë, pas miratimit paraprak nga Kuvendi.

Kontingjenca për risqet e borxhit prej 4 000 milionë lekësh përdoret për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhajtjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Neni 14

Fondi për rritjen e pagave prej 1 000 milionë lekësh shpërndahet nga Ministria e Financave mbi bazën e nivelit të pagave që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Shumat e

shpërndara nga ky fond shtojnë kufijtë e miratuar në nenet 3, 5 dhe 17, si dhe në tabelën 1, që përmendet në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 15

Buxheti i pushtetit gjyqësor administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 8363, datë 1.7.1998, “Për krijimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”. Bordi i kësaj zyre bën shpërndarjen e fondeve buxhetore nga programi i buxhetit gjyqësor, sipas tri niveleve të këtij pushteti, deri në momentin e krijimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 16

Transferta e pakushtëzuar, që buxheti qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshin fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transferta e pakushtëzuar shpërndahet ndërmjet njësisve të vetëqeverisjes vendore, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore paraqitet në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi rezervë nga totali i transfertës së pakushtëzuar përdoret nga Ministria e Financave, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përdoret sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondet për funksionet e reja të transferuara në bashkitë shpërndahen sipas aneksit 4, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrisë të Brendshme detajon, sipas bashkive, fondin për investime për funksionin e mbrojtjes nga zjarri, parashikuar në tabelën 3, bashkëlidhur këtij ligji.

Ministri i Financave nxjerr një udhëzim specifik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Ky udhëzim përcakton dhe shumën që njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet t’i paguajnë të tretëve për detyrimet e prapambetura ndaj tyre.

Ministri i Financave, brenda vitit 2018, përcakton standardet për kostot administrative të personelit për bashkitë.

Personeli administrativ i këshillit të qarkut nuk mund të jetë më shumë se 10 veta.

Neni 17

Fondet e buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë shpërndahen në formën e grantit. Ky fond shpërndahet sipas kategorive; a) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë; b) granti i mësimdhënies; c) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese. Modeli i financimit për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kriteret për përdorimin e granteve të politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese janë përcaktuar në nenin 111 dhe nenin 113, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 18

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet programeve brenda të njëjtit institucion buxhetor apo ndërmjet programeve

të institucioneve të ndryshme nga Këshilli i Ministrave deri në masën 10 për qind të shumës së përgjithshme të shpenzimeve korrente apo shpenzimeve të përgjithshme kapitale, duke ruajtur totalin e shpenzimeve korrente dhe kapitale. Bëjnë përjashtim nga ky rregull shpenzimet që përfshihen në Fondin për Zhvillimin e Rajoneve dhe shpenzimet për institucionet e sistemit të drejtësisë, të cilat mund të transferohen nga një program në tjetrin apo në pushtetin vendor pa kufizim.

Neni 19

Tavani për vlerën totale të kontratave në përqindje të PBB-së për të gjitha projektet koncesionare/PPP-të ekzistuese dhe ato të kontraktuara rishtazi për vitin 2018, në përputhje me të dhënat e regjistrit të koncesioneve është 40,1 % e PBB-së.

Këshilli i Ministrave (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) raporton në Komisionin për Ekonominë dhe Financat për çdo kontratë të re të koncesioneve dhe partneriteteve publike private, që nënshkruhet dhe i shtrin efektet brenda vitit buxhetor, në funksion të ruajtjes së tavanit për vlerën totale të kontratave në përqindje të prodhimit të brendshëm bruto.

Neni 20

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të stokut të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2018, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit, është deri në 33 466 milionë lekë, i dhënë me hollësi si më poshtë:

- Për huamarrjen totale neto vjetore, përfshirë të brendshme, të huaj, si dhe gjendjen e likuiditetit të trashëguar nga viti 2017, deri në 32 366 milionë lekë, nga e cila, limiti i huamarrjes së brendshme neto mund të jetë deri në 29 947 milionë lekë.

- Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, deri në 1 100 milionë lekë.

Stoku i borxhit publik total, përfshirë borxhin shtetëror të garantuar, vlerësohet të arrijë në 1 135 620 milionë lekë, pa përfshirë efektet e mundshme prej ndryshimit të kursit të këmbimit.

Neni 21

Në rast të emetimit të një eurobondi të ri, kufiri për huamarrjen totale neto, rritjen vjetore të stokut të borxhit dhe nivelin e vlerësuar të stokut të borxhit, të përcaktuara në nenet 9 dhe 20, mund të tejkalohen me vlerën e eurobondit të emetuar. Ndërkohë niveli i deficitit të buxhetit të vitit 2018 mbetet i pandryshuar, sipas përcaktimit në nenin 1. Qeveria mund të akumulojë dhe mund të mbajë në llogarinë e qeverisë në Bankën e Shqipërisë çdo gjendje shtesë të likuiditetit që mund të krijohet. Çdo gjendje likuiditeti e akumuluar gjatë vitit fiskal mund të mbartet për të financuar buxhetet e vitit fiskal pasardhës, por pa kaluar kufirin prej dy muaj shpenzime buxhetore.

Neni 22

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2018.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miraturar në datën 30.11.2017